



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
TEATRI KOMBËTAR I OPERËS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR
DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I SHËRBIMEVE

Nr. 828 prot.

Tiranë, më 11.09.2024

NJOFTIM

Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansambilit Popullor, në zbatim të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 90, datë 27.09.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, ligjit nr. 10 352, datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën”, i ndryshuar, Urdhrit të Kryeministrit nr.140, datë 28.03.2014 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës të TKOBAP”, i ndryshuar, Statutit të TKOBAP-së miratuar me urdhër të Ministrit të Kulturës nr. 166, datë 27.04.2015 dhe Rregullores së Brendshme “Për Organizimin dhe Funksionimin e TKOBAP-së”, **shpall audicionin e brendshëm për pozicionin e lirë të punës “Solist i Dytë Lirik (bas)” pranë Drejtorisë së Operës dhe Filarmonisë.**

Audicioni do të zhvillohet në datën 11.10.2024, ora 14:00, në Hollin e Katit të Dytë të Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansambilit Popullor.

Të gjithë ata artistë të brendshëm të interesuar për pjesëmarrje në këtë audicion, duhet të dorëzojnë pranë Zyrës së Protokollit ose të skanuar në adresën në postën elektronike zyrtare të TKOBAP-së sekretaria@tkob.gov.al, deri në datën 4.10.2024, ora 16:30 një letër shprehje interesi për pozicionin e lirë të punës.

Programi:

***Programi për konkurimin është interpretimi i roleve të plota (përzgjedhja e roleve për interpretimin nga kandidatët do të bëhet Komisioni i Vlerësimit) nga veprat e mëposhtme:**

Don Pasquale (Don Pasquale)

Flauti magjik (Sarastro)

La Bohème (Colline dhe Benoit)

Il Trovatore (Ferrando)

Samson et Dalila (Abimelech)

Shënime:

- 1. Komisioni ruan të drejtën të dëgjojë të gjithë ose një pjesë të programit të konkursit.**
- 2. Nëse aplikantët nuk do të kenë shoqërues në piano me vete, Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansambli Popullor do të mundësojë një shoqërues në piano në ditën e audicionit pasi të jetë lajmëruar paraprakisht nga aplikanti në momentin e depozitimit të letrës së shprehjes së interesit.**
- 3. Aplikantët do të lajmërohen nëpërmjet e-mail-it për zhvillimin e audicionit brenda 7 (shtatë) ditëve nga afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar për pozicionin e punës.**

Për sqarime të mëtejshme, ju lutem mos hezitoni të na kontaktoni në adresën e postës elektronike: sekretaria@tkob.gov.al.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Abigeila Voshtina

